



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 06.03.2026

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, në pajtim me dispozitave e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në harmoni me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ MMPH – NR.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Komisioni për Përjashtimet thërret:

TAKIM PUBLIK

Komisioni për Përjashtimet mbi kërkesat për Kushte ndërtimore /Leje ndërtimore, organizon Takim Dëgjimorë të hapur dhe publik me qytetarët e interesuar për trajtimin e kërkesës / parashtrësës për përjashtime në zonën si:

- Zona jug lindore e Komunës së Gjakovës – zona përgjatë rrugës tranzite ish “ Tirana “, parcela kadastrale (pjesë) me numër P-70705028-05077-2 Z.K. Gjakovë jashtë qytet., aplikuesi Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për ngritjen e objektit “SHTËPI PËR MBROJTJEN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE;

Qëllimi i dëgjimit publik është shqyrtimi i propozimeve për përjashtime për Kushte ndërtimi / Leje ndërtimore, në lokacionin të cilin e gjeni të bashkëngjitur me këtë Njoftim Publik.

Lokacioni për ndërtimin e objektit të banimit sipas destinimit të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor si Harta Zonale e Komunës 2024-2032 dhe kërkesa për përjashtim që i referohet mundësimin të shfrytëzimit dhe zhvillimit të parcelës pa përmbushur kushtin e locimit të ndërtimit / pozicionimit të vijës ndërtimore në distancë 6.0m nga vija rregulluese e rrugës publike qasëse në parcelë dhe ky element imponohet nga forma jo e rregullt e parcelës kadastrale për zhvillim dhe kufizimi, pozicionimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Trakaniq, për:

- PËRJASHTIMI I REFEROHET APLIKIMIT TË VIJËS SË NDËRTIMIT NË DISTANCË D=6.0M’ NGA VIJA RREGULLATIVE ;

Takimi Dëgjimorë dhe Publik me qytetarët e interesuar do të mbahet me datën 13.03.2026 (e premtë), në orën 10⁰⁰ në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Kopjet fizike të këtyre dokumenteve mund të tërhiqen në objektin e Administratës të Komunës së Gjakovës, rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë çdo ditë pune prej orës 10⁰⁰ deri në orën 14⁰⁰, duke filluar nga data 06.03.2026 deri në ditën e organizimit të takimit publik me datë 13.03.2026, pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Gjakovës
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Kryesuesja e Komisionit
Elida Bejtullahu